



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 87

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “REPORT TV”, “AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE”, “TV1- CHANNEL”, “SYRI TV”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 19.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

**KËRKUES:**

1. “Report TV”, me seli në Tiranë, Rruga “Niko Pushkin” dhe përfaqësuese zj. Vilma Theodhosi;
2. “ATSH”, me seli në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali”, dhe përfaqësuese zj. Valbona Zhupa;
3. “TV1 Channel”, me seli në Shkodër, Lagjja “Qemal Stafa”, dhe përfaqësues z. Edmond Ndou;
4. “Syri TV”, me seli në Tiranë, Rruga “Rruga Veli Dedi”, dhe përfaqësues z. Gazmir Spahija;

**OBJEKTI:**

Kërkohet akreditimi si vëzhgues i gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,



Data: 19 Shkurt 2022

Nr. 87

“Për shqyrtimin e kërkesës së “Report TV”, “Agjencia Telegrafike Shqiptare”, “TV1- Channel”, “Syri TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”

## VËREN:

“Report TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 45 (dyzet e pesë) gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “Report TV” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“ATSH” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 11 (njëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “ATSH” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“TV1-Channel” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 13 (trembëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “TV1-Channel” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“Syri TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 40 (dyzet) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “Syri TV” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



## V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 45 (dyzet e pesë) gazetarëve dhe operatorëve të “Report TV”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të e 11 (njëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të “ATSH” sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të e 13 (trembëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të “TV1-Channel” sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 40 (dyzet) gazetarëve dhe operatorëve të “Syri TV”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

